

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e RM”, nr. 5/02) dhe nenit 33 pika 1 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale („Gazeta zyrtare e RM”, nr. 61/04, 22/07, 67/07 dhe 156/09), Këshilli i Komunës së Tetovës, në mbledhjen e mbajtur me dt.06.04.2017, miratoi:

## LLOGARIA PËRFUNDIMTARE E BUXHETIT TË KOMUNËS SË TETOVËS PËR VITIN 2016

### Neni 1

Shuma e përgjithshme e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2016 janë:

	Të planifikuara	Të realizuara
<b>I. Të hyrat e përgjithshme</b>	1.967.097.578 denarë	1.247.762.497 denarë
Të hyrat tatiimore	511.596.000	218.163.301
Të hyrat jotatimore	99.712.452	50.923.618
Të hyrat kapitale	280.550.000	30.693.787
Të hyrat nga dotacionet	867.140.924	862.990.144
Transfere	178.022.015	75.206.962
Të hyrat nga donacionet	30.076.187	9.784.685
<b>II. Shpenzimet e përgjithshme</b>	1.967.097.578 denarë	1.243.647.710 denarë
Destinimet e përcaktuara	1.959.597.578	1.242.147.710
Rezervat	7.500.000	1.500.000
<b>III. Suficit</b>		4.114.787 denarë
<b>IV. Financimi</b>		0
Të hyrat		0
Të hyrat e brendshme		0
Të hyrat nga kreditë e huaja		0
Depozitë		0
Shpenzimet		0
Pagesa bazë		0



## Neni 2

Saldoja e të gjitha llogarive të Buxhetit të Komunës së Tetovës me dt.31.12.2016 është (28.640.170) që paraqet mbledhjen e suficit të vitit aktual 2016 ( 11.691.393 denarë) dhe nga tepirica e bartjes së të hyrave nga viti paraprak 2015 ( 16.948.777 denarë ) dhe është

<b>Saldo 31-12-2016</b>	<b>28.640.170 denarë</b>
Saldo buxheti themelor	10.218.914 denarë
Saldo buxheti-dotacione	8.194.027 denarë
Saldo buxheti –aktivitete vetëfinancuese	1.333.344 denarë
Saldo buxheti - donacione	8.893.885 denarë

Dallimi midis të hyrave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera të buxhetit themelor në shumë prej 10.218.914 denarë bartet si të hyra të buxhetit themelor të buxhetit të Komunës së Tetovës për vitin 2017.

Dallimi midis të hyrave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera të buxhetit të dotacioneve në shumë prej 8.194.027 denarë bartet si të hyra të buxhetit të dotacioneve të Komunës së Tetovës për vitin 2017.

Dallimi midis të hyrave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera të buxhetit të aktiviteteve vetëfinancuese në shumë prej 1.333.344 denarë bartet si të hyra të buxhetit të aktiviteteve vetëfinancuese të Komunës së Tetovës për vitin 2017.

Dallimi midis të hyrave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera të buxhetit të donacioneve në shumë prej 8.893.885 denarë bartet si të hyra të buxhetit të donacioneve të të Komunës së Tetovës për vitin 2017.



### Neni 3

Të hyrat e planifikuara dhe të realizuara sipas burimeve dhe llojeve, respektivisht shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara sipas destinimeve themelore janë shprehur në bilancet e të hyrave dhe shpenzimeve.

### Neni 4

Në pjesën e veçantë të llogarisë përfundimtare të buxhetit të Komunës së Tetovës për vitin 2016 janë shprehur shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara sipas nënprogrameve, llogarive dhe destinimeve themelore.

### Neni 5

Pjesa e përgjithshme e llogarisë përfundimtare të buxhetit të Komunës së Tetovës për vitin 2016 do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Tetovës".

Бр./Nr.08-3620/5  
06.04.2017 год.  
Тетово/Tetovë

Совет на Општина Тетово  
Претседател,  
Хисен Џемаили

Këshilli i Komunës së Tetovës  
Kryetar,  
Hisen Xhemili

